

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PËRITIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Llog. Dep. D-P Nr. i treg. 01 Nr. i reg. 01	N. Prot. 03-113/2012 Prot. No. Data 16.01.2012 Datim. Data
PRISHTINE	

GJL.Nr.1573/2011

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Dalip Bega dhe Ragip Namani anëtarë, me pjesëmarrjen e sek.juridike Sanije Salihu, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Halit Ymeri nga Prishtina, nëpërmjet mbrojtëses së tij avokates Sadije Mjekiqi, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24895/11 të dt. 14.10.2011, në bazë të nenit 31, al.3,39 dhe 220 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 23.12.2011, mori

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e paraqitur si e **PABAZUAR**

VËRTETOHET aktvendimi i goditur si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, ka korrigjuar aktvendimin e të njëjtës Gjykatë Regj.I.nr.24895/11 të dt.14.10.2011, lidhur me lëshimin e gabimit teknik për sa i përket mbiemrit të pandehurit dhe ka shpall përgjegjës të pandehurin Halit Ymeri nga Prishtina, sepse si drejtor i Qendrës Diagnostiko Radiologjike në QKU-në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencioni Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë i njoftuar se është përfshirë në listën e Zyrtarëve të Qendrës Klinike Universitare, të çilet janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, me ç,veprim ka kryer kundërvajtje nga neni 6 pika 2 lidhur me nenin 16 par. 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje të pandehurit i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 800 Euro. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë 5 Euro.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Halit Ymeri, nëpërmes mbrojtëses së tij avokates Sadije Mjekiqi, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Ligjit për kundërvajtje dhe shkeljeve të Ligjit mbi deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtarëve të lartë publik dhe vendimit mbi dënimin. Thekson se dispozitivi i aktvendimit përmban shkelje të shumta të procedurës së Ligjit për kundërvajtje, për shkak se mbiemri i të pandehurit është shkruar gabim (Zymeri), kurse mbiemri i vërtetë është Ymeri, se nuk është përcaktuar koha-periodha e kundërvajtjes dhe nuk është dëgjuar dëshmitarja Razije Abazi, se gjoba e shqiptuar ndaj tij deri sa gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe plotësisht nuk është ligjore dhe është shumë e lartë se nuk janë marrë vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese para se të caktohet gjoba, andaj ka propozuar që aktvendimi i goditur të abrogohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje ose të ndryshohet e ai të lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse, apo ti shqiptohet një dënim më i butë.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur dhe aktvendimin e korrigjuar, deklarinimin e dhënë të pandehurit në seancën shqyrtimit kryesor pranë gjykatës së shkallës së parë në procesverbal të dt.26.09.2011, deklarinimin e dëshmitarit Lulzim Emiri ushtrues i Drejtorit në QKU-në, si dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka gjetur se:

Ankesa e paraqitur është e pabazuar.

Nga provat e deponuara dhe të administruara nga Gjykata e shkallës së parë pa dyshim është vërtetuar gjendja faktike se i pandehuri e ka kryer veprën kundërvajtëse, për të cilën e mbanë përgjegjësinë kundërvajtëse, andaj nuk ka bazë për ndryshimin e aktvendimit të goditur siç ka propozuar i pandehuri në ankesën e paraqitur.

Meqë i pandehuri në mbrojtjen e tij në procesverbal të marrjes në pyetje në disa rrethana relevante e ka pranuar kundërvajtjen që me kërkesë për fillim të procedurës kundërvajtëse i është vu në barrë, dhe pastaj nga procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit i cili në mes tjerash ka thënë se të gjithë zyrtarët që kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë kemi njoftuar me kohë, përmes sekretares e cila paraprakisht ka qenë e informuar nga shefi i shërbimit. Të njëjtëve u është treguar edhe adresa në VEB, dhe Gjykatës ia ka prezantuar të gjitha provat mbi informimin e zyrtarëve të lartë, nga të cilat shifet se nuk ka bërë deklarinë e rregullt të pasurisë në AKK, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2011, dhe nuk ka deklaruar pasurinë në AKK as me rastin e marrjes së detyrës, andaj nga e lartshënuara rrjedh se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka shpall përgjegjës të pandehurin, për kundërvajtje nga neni 6.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të drejtës materiale në dëm të pandehurit, kurse dënimi i shqiptuar të pandehurit konsiderohet se është përcaktuar sipas shkallës së përgjegjësisë, veprës së kryer dhe rrethanave në të cilën është kryer vepra, andaj edhe në këtë drejtim nuk ka bazë ligjore për zbutjen e mëtejme të dënimit të shqiptuar.

Më sa u tha më lartë konformë nenit 220 të Ligjit mbi kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL. Nr. 1573/2011 të dt. 23.12.2011.

SEK. JURIDIKE
Sanije Salihu



KRYETARI I KOLEGJIT

Ramiz Kuqi